



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gllogoc)
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 10163-45473 dt. 13/09/ 2024

Bazuar në nenin 12,40, 44 dhe 41 pika 41.1, 41.2, 41.3, 41.4, 41.5 të Ligjit nr.03/l-040, për Vetëqeverisje Lokale, neni 3, të Udhëzimit Administrative nr. 02/2015, dhe neni 35 të Statutit të Komunës së Drenasit/Gllogocit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën: 13.9.2024, miratoi këtë:

V E N D M

Neni 1

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Drenasit (Gllogocit), zgjedhet z. Bekim Lestrani nga fshati Baicë Komuna e Drenasit (Gllogocit) duke filluar nga data 13.9.2024.

Neni 2

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Drenasit (Gllogocit) zgjidhet deri në përfundim të mandatit 4 (katër) vjeçar, njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Neni 3

Me këtë vendim do të njoftohet Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Drenasit(Gllogocit), Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës së Përgjithëshme të Komunës si dhe zyra e Personelit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatesë;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit
- Palës



Kryesuesi i mbledhjes të KK

Gani Krasniqi



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Ramiz Lladrovc, Kryetar i Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL-së	
Nga:	Erbllin Hetemi, U.d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 18.09.2024 VI-020-569
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
	2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 02 Nr. 101/03-45473 për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Glllogocit
I miratuar më datë: 13.09.2024
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 16.09.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Gllgocit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 13.09.2024, ka miratuar Vendimin 02 Nr. 101/03-45473 për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Gllgocit.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Gllgocit, është bazuar në nenet 12, 40, 44 dhe 41 pika 41.1, 41.2, 41.3, 41.4, 41.5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 3 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015, dhe në nenin 35 të Statutit të Komunës së Gllgocit.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Gllgocit me datë 13.09.2024, është miratuar më 17 vota për, 13 kundër dhe 1 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.